



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Data:	05.04.2016
Referencë:	
Nga:	Heset Sahiti - Drejtor i DSHP-së
Për:	Kryetarin e Komunës z. Imri Ahmeti
Lënda:	Raporti i muajit Mars 2016

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave gjatë muajit Mars 2016, DSHP-ja ka kryer punë dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve dhe nga ana e institucioneve. Kërkesat janë të paraqitura në mënyrë tabelore:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave) për muajin janar				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
37	28		1	8

- Barazimi i të hyrave me kompaninë “Algemi” sh.p.k e cila mirëmban dhe menaxhon me tregjet.
- Mbikëqyrja e rrugëve dhe e trotuareve në qytetin e Lipjanit si dhe rrugëve lokale.
- Mbikëqyrja e kompanisë KRM “Pastrimi” e cila bënë pastrimin e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Lipjanit
- Mbikëqyrja e kompanisë “Te Muhameti” e cila bënë mirëmbajtjen e parqeve dhe parkingjeve në qytetin e Lipjanit.
- Janë dhënë përgjigje, njoftime të ndryshme sipas kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve.
- Kërkesë KUR Prishtina për largimin e gypit të ujës-jellës nga gypi i rrjetit të kanalizimit në fsh. Medvec.
- Janë bërë kërkesa për zotim të mjeteve: ndërtimi i hapësirave publike – trotuareve në qytet, rehabilitimi i ujës-jellës në Bujari, vendosja e reklamës për çmimet në aeroport, mirëmbajtja dhe vendosja e shenjave të trafikut në disa rrugë në qytet.
- Kërkesë Drejtorisë së Inspektoratit për inspektim bizneseve për pagesën e taksës për shfrytëzim të hapësirës publike
- Vizita në teren për përgatitjen e paramanave dhe parallogaritje sipas kërkesave të drejtorateve dhe palëve.
- Janë rregulluar dhe vendosur disa shenja të komunikacionit në rrugët e qytetit.
- Pjesëmarrja në komisionet komunale, është duke u punuar në hartimin e rregullores për shërbime publike.
- Kërkesë Drejtorisë së Prokurimit për inicim të procedurave për projektet: ndërtimi i trotuareve në fshatin Banullë, shërbimet e mirëmbajtjes së rrjeteve të kanalizimit në tërë komunën.
- Kërkesa Shërbimit Pronsoro – Juridik dhe DGJK për definimin e pronës dhe caktimin e pikave për ndërtimin e trotuareve në fshatin Banullë.

- Marrja pjese ne hapje dhe ne vlerësim te ofertave tenderuese për projektet e infrastrukturës
- Puna me palë.
- Punë tjera në teren sipas kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe institucioneve.

Janë kryer edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës së DSHP-së me urdhër të Drejtorit.

Pasqyra e aktiviteteve të DSHP-së		
Nr	Lloji i aktivitetit	Nr.
1	Kërkesa, njoftime, pëlqime, përgjigje si dhe shkresa te ndryshme organeve brenda komunës dhe institucioneve tjera	28
2	Takime me përfaqësuesit e fshatrave	5
3	Përgatitja e paramasave dhe parallogarive	10
4	Takime zyrtare në Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit	0
5	Takime zyrtare në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	0
6	Takime zyrtare në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal	0
7	Vizita në terren	42
8	Pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të ndryshme	1
9	Pjesëmarrja në hapjen dhe vlerësimin e tenderëve	4